



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AVOKATI I POPULLIT

---

**“MBI FENOMENIN E GJAKMARRJES NË SHQIPËRI”**

**RAPORT I VEÇANTË (II)**



**Dhjetor 2015**

## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje.....faqe 3
2. Reagimi i Avokatit të Popullit lidhur me këtë fenomen dhe rekomandimet e bëra pas dërgimit në Kuvend të Raportit të parë të Veçantë..... faqe 5
3. Organizimi i konferencës për gjakmarrjen dhe konkluzionet e rekomandimet e saj .....faqe 8
4. Rekomandimet e bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit pas Konferencës Kombëtare ...faqe 11
5. Organizimi i disa aktiviteteve sensibilizuese për gjakmarrjen në Qarkun e Shkodrës gjatë vitit 2015.....faqe 15
6. Situata aktuale e fenomenit të gjakmarrjes në vend në bazë të të dhënave zyrtare.....faqe 18
7. Azilkërkuesit shqiptarë në shtetet e zonës Shengen, mashtrimet me gjakmarrjen për të kërkuar azil në shtetet anëtare të BE-së dhe reagimi i strukturave ligjzbatuese shqiptare.....faqe 25
8. Konkluzione dhe Rekomandime për parandalimin e fenomenit të gjakmarrje.....faqe 29

## **RAPORT I VEÇANTË nr. 2 “MBI FENOMENIN E GJAKMARRJES NË SHQIPËRI”**

### **1. Hyrje**

Gjakmarrja në Shqipëri tashmë është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë, sepse cënon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës. Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e vuajnë edhe disa vende të BE-së për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptarë të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Raporte të ndryshme në lidhje me azilkërkuesit nxjerrin që, një ndër faktorët kryesorë në kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë në BE ka të bëjë me gjakmarrjen. Ky shqetësim është pasqyruar edhe në Progres - Raportin e fundit (2015) të KE-së për Shqipërinë, ku theksohet se: “Sa i përket të drejtës së jetës, **gjakmarrja mbetet një problem, megjithëse në një shkallë të kufizuar.**

Në mars, Parlamenti miratoi një rezolutë dhe rekomandimet për gjakmarrjen, bazuar në gjetjet e raportit të veçantë të Avokatit të Popullit. Rezoluta bën thirrje për këshillin koordinues për parandalimin e gjakmarrjes, të ngritur që në vitin 2005, për programet arsimore dhe sociale që të drejtohen në zonat rurale, dhe për prokurorinë dhe policinë që të shtojnë përpjekjet hetimore dhe për të bërë më shumë në parandalimin e konflikteve”.

Për shkak të gjakmarrjes në vendin tonë kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative dhe regressive sikurse mund të përmendin *ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe*, duke u mohuar personave të ngujuar një sërë të drejtrash themelore kushtetuese, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.

Duke vlerësuar të drejtën e jetës si të drejtën themelore dhe më të rëndësishme të njeriut, duke pranuar edhe rrezikun që e kanos çdo ditë këtë të drejtë nga fenomeni i

gjakmarrjes dhe i hakmarrjes, Avokati i Popullit në zbatim të misionit të tij kushtetues e ligjor, ka marrë iniciativën për sensibilizimin e institucioneve shtetërore, fetare, shoqërisë civile, medias dhe individëve në çështjen sensitive të gjakmarrjes duke organizuar disa aktivitete me këtë tematikë, bërë disa rekomandime institucioneve shtetërore dhe përgatitur e dërguar në Kuvend një Raport të Veçantë. Në këtë raport ndërmjet të tjerave janë pasqyruar shkaqet e ekzistencës së këtij fenomeni, janë nxjerrë disa konkluzione dhe janë bërë disa rekomandime për Institucionet e Administratës Publikelidhur me këtë fenomen.

Raporti i parë i veçantë për problemin e gjakmarrjes, i cili u përgatit gjatë vitit 2012, u dorëzua në Kuvendin e Shqipërisë në muajin Prill 2013. Ky rapport u morrë në shqyrtim nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit në datën 17.11.2014 dhe Kuvendi në datën 05.03.2015 ka miratuar një Rezolutë për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri, e cila ështëbotuar në Fletoren Zyrtare të vitit 2015, nr. 38, faqe 1760.

Në këtë Rezolutë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i kërkon:

- Qeverisë, që organet e administratës publike të vlerësojnë seriozisht fenomenin e gjakmarrjes, të forcojnë bashkëpunimin dhe të bashkërendojnë mes tyre dhe me organizatat joqeveritare për parandalimin e gjakmarrjes dhe hakmarrjes.
- Institucionit të Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit, që të koordinojnë punën e tyre dhe të zhvillojnë hetime më të shpejta, të plota dhe objektive, duke zbatuar një politikë penale efektive, ndaj personave që përfshihen në vepra penale të gjakmarrjes ose hakmarrjes.
- Organeve të Policisë së Shtetit, që të marrin masa për parandalimin e konflikteve, për zbulimin dhe dërgimin e personave të akuzuar tek organi e prokurorisë, duke forcuar bashkëpunimin me organet homologe dhe me Interpolin për ekstradimin e personave në kërkim ose të dënuar nga gjykatat shqiptare për veprat penale me motive gjakmarrjeje ose hakmarrjeje.
- Këshillit Koordinues në Luftën Kundër Gjakmarrjes funksionimin, me qëllim hartimin e një strategjie kombëtare në luftën kundër gjakmarrjes, marrjen e masave në planin ekonomik, social dhe legjislativ dhe përgatitjen e akteve nënligjore për funksionimin e këtij këshilli.

- Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për të rritur rolin informues dhe edukues mes përmirësimit të programeve mësimore dhe veprimtarive edukative, që synojnë edukimin me fryshtë e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, gjakmarrjes dhe hakmarrjes, si dhe të vlerësohet krijimi i lehtësive për arsimtarët që përfshihen në programet mësimore të edukimit të fëmijëve të ngujuar.
- Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që të përfshihet specifisht, nëpërmjet zyrave rajonale të saj, për të ndihmuar familjet e ngujuara, me të ardhura të pamjaftueshme, nëpërmjet programeve të posaçme të ndihmës ekonomike dhe mundësitetë e ofrimit të punësimit të tyre.
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson nevojën e ndryshimeve, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues për parandalimin dhe zhdukjen e këtij fenomeni primitiv. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkon angazhimin e të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, medias dhe shoqërisë civile të veprojnë bashkërisht për dhënien fund të plagës sociale të gjakmarrjes.

Mirëpo edhe pas bërjes e dorëzimit në Kuvend të Raportit të Veçantë, si dhe pas miratimit të kësaj rezolute, konstatojmë se nuk është bërë ndonjë zgjidhje konkrete nga institucionet e shtetërore për zbatimin e detyrave të caktuara nga Kuvendi për parandalimin e këtij fenomeni dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatimin e ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005. Përballë kësaj indiference të institacioneve shtetërore nuk mund të qëndronim në heshtje.

## **2. Reagimi i Avokatit të Popullit lidhur me këtë fenomen dhe rekomandimet e bëra pas dërgimit në Kuvend të Raportit të parë të Veçantë:**

Megjithë rekomandimet drejtuar Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2012 e në vijim për përgatitjen dhe miratimin e tre akteve nënligjore, VKM në bazë e për zbatimin e Ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, ato akoma nuk janë miratuar. Është koha e duhur që të risjellim në vëmëndje përbajtjen e këtij ligji.

Ky ligj ka si qëllim të organizojë dhe të koordinojë më mirë masat dhe luftën e organeve shtetërore, institucioneve shoqërore, shkencore, fetare etj., si dhe të përcaktojë një strategji afatgjate për parandalimin dhe eleminimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri.

Në bazë të nenit 2 të këtij ligji, Krijohet Këshilli Koordinues nën drejtimin e Presidentit të Republikës, me pjesëmarrjen e Zëvendëskryeministrat, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Arsimit, Prokurorit të Përgjithshëm, Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit.

Në mbledhjen e Këshillit Koordinues ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organizatave jofitimprurëse në fushën e të drejtave të njeriut dhe të besimit.

Në bazë të nenit 3 të ligjit Këshilli Koordinues ka këto funksione:

- a) harton strategjinë kombëtare për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ, etj. dhe përcakton detyrat dhe masat konkrete për organet ekzekutive e ato të pushtetit vendor;
- b) nxit koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse për organizimin e luftës kundër fenomenit të gjakmarrjes;
- c) thërret ne raport një herë në tre muaj organet e përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes dhe u cakton atyre detyra konkrete, sipas fushës së veprimtarisë që kryejnë;
- ç) u sugjeron organeve përkatëse, të ngarkuara me detyra sipas këtij ligji, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe marrjen e masave për strukturat dhe personat përgjegjës të ngarkuar për t'i kryer ato.

Në nenin 4 të ligjit parashikohet bashkëpunimi i Këshillit Koordinues me organet shtetërore. Ai nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Brendshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm, evidenton, nëpërmjet studimeve që kryejnë këto organe, përhapjen dhe shtrirjen e krimit të gjakmarrjes e të fenomeneve të tjera që lidhen me të në shkallë Republike dhe orienton përgatitjen e nismave ligjore në fushat përkatëse.

Në nenin 5 parashikohet koordinimi me qeverisjen vendore. Këshilli Koordinues përcakton platformën dhe mënyrën e organizimit dhe të koordinimit të veprimtarisë me organet e qeverisjes vendore.

Ndërsa në nenin 6 parashikohet ngritja e Sekretariatit Teknik pranë Këshillit Koordinues, i cili ndjek detyrat dhe ndihmon atë në kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu në nenin 7 të këtij ligji parashikohet nxjerra nga Këshilli i Ministrave i tre akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të tij

Gjatë vitit 2013 e në vijim Avokati i Popullit e ka patur në fokusin e veprimtarisë së përditëshme ligjore çështjen sensitive të gjakmarrjes. Institucioni ka vazduar punën për sensibilizimin e të gjithë administratës publike shqiptare, të organeve ligj zbatuese të drejtësisë, të shoqërisë civile, të komuniteteve fetare, të medias, të individëve etj, me qëllim që të luftohet ky fenomen dhe pasojat e tij, si dhe të zbatohen rekomandimet e bëra ndaj tyre lidhur me këtë problem shqetësues.

Sipas gjykimit dhe bindjes së institucionit tonë, një nga shkaqet që ka ndikuar negativisht për ekzistencën e këtij fenomeni është edhe mosbatimi i ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, ndonëse ka 10 vjet që ka hyrë në fuqi.

Gjithashtu kemi konstatuar dhe kemi bindjen e plotë se, shkak për mosbatimin e këtij ligji ka qënë mungesa e vullnetit të Qeverisë përgatitjen dhe miratimin nga KM i tre akteve nënligjore në bazë e për zbatim të nenit 7 të ligjit.

Megjithëse në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit drejtar Këshllit të Ministrave doli Urdhri i Kryeministrit nr. 136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, pothuajse nuk pati ndonjë zhvillim të mëtejshëm lidhur me miratimin e akteve nënligjore të cituara më sipër. Për ta nxitur më tej procesin, Avokati i Popullit me shkresat e datës 27.11.2013 dhe 14.01.2014 i ka kërkuar Ministrit të Punëve të Brendshme informacion lidhur me përgatitjen (hartimin) nga grupei i punës i cili kryesohet nga Zëvëndësministri i Brendshëm, të akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005.

Pas kërkesave të përsëritura, Ministri i Punëve të Brendshme me shkresën nr. 452/2 Prot., datë 07.02.2014 na ktheu përgjigje dhe na informoi se, grupi i punës i ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrat nr. 136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, nuk ka përgatitur aktet nënligjore.

Ndërkohë gjykuam se, thirrja e Këshillit Koordinues jo vetëm që është një detyrim ligjor, por do të jetë edhe një nxitje dhe mbështetje e madhe ndaj organeve shtetërore të përfshira drejtpërdrejtë në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes për të kryer detyrat ligjore. Sipas Institucionit të Avokatit të Popullit, kjo do të jetë edhe një shpresë më shumë ndaj atyre personave që janë prekur nga ky fenomen dhe për aktorët e tjere të shoqërisë tonë që punojnë në këtë fushë. Gjithashtu thirrja e këtij organi do të ketë edhe efekte parandaluese të vrasjeve për gjakmarrje dhe të pasojave të tyre.

Për këto arsyе i kemi kërkuar Presidentit të Republikës Z. Nishani respektivisht me shkresat e dt. 12.03.2013 dhe dt. 27.11.2013 thirrjen e Këshillin Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes.

Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresën nr. 2223/1 Prot., datë 31.12.2013 ndërmjet të tjerave na informoi se, Këshilli Kordinues nuk është mbledhur për shkak të mosnxjerrjes së akteve nënligjore. Gjithashtu nëpërmjet kësaj shkrese informohemi se, me plotësimin e bazës ligjore, Presidenti i Republikës ka vullnetin e plotë në thirrjen sa më shpejtë të Këshillit për të vijuar me detyrat që ngarkon ligji për të luftuar fenomenin e gjakmarrjes.

Lidhur me këtë përgjigje të Institucionit të Presidentit shprehim opinionin tonë se, qëndrimi i mbajtur prej tij duke mosvepruar për thirrjen e Këshillit Koordinues, nuk është i bazuar në ligj. Ligji në fjalë nuk e kushtëzon thirrjen e këtij këshilli me nxjerrjen dhe miratimin e akteve nënligjore dhe krijimin e Sekretariatit Teknik.

### **3. Organizimi i konferencës për gjakmarrjen dhe konkluzionet e rekomandimet e saj**

Institucioni i Avokatit të Popullit në datat 10 e 11 dhjetor 2013, në bashkëpunim me disa OJQ organizoi një Konferencë Kombëtare. Duke e vlerësuar seriozisht fenomenin e gjakmarrjes, pasojat e tij dhe shqetësimin që ka sjellë ai në shoqërinë tonë, si dhe duke konstatuar mosreagimin e strukturave shtetërore për t'u angazhuar seriozisht në luftën kundër tij, një seancë e kësaj konference iu kushtua fenomenit të gjakmarrjes.

Në këtë konferencë u ftuan drejtues të institucioneve qëndrore të administratës publike, drejtues të institucioneve vendore ku është i përhapur ky femomen, organizata të shqoqërisë civile që kanë objekt të punës së tyre mbrojtjen e jetës dhe të drejtave themelore të njeriut, përfaqësues të komuniteteve fetare, të medias etj. Institucionet qëndrore të administratës publike u përfaqësuan nga titullarët e tyre sikurse mund të përmendim Ministren e Arsimit dhe të Sportit, Ministrin e Mirëqënieve Sociale dhe Rinisë, Ministrin e Shëndetësisë.

Nga fjalimet e të ftuarve dhe diskutimet e pjesëmarrësve konferanca arrii të evidentojë disa konkluzione dhe rekomandime si mëposhtë:

- Gjakmarrja në Shqipëri ndonëse e lokalizuar në disa zona është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë sepse cënon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës.
- Për shkak të saj kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative sikurse mund të përmendin, ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe, duke iu mohuar një sërë të drejtash kushtetuese themelore, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.
- Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e ndiejnë dhe vuajnë edhe disa vende të BE-së për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptarë duke përfshirë edhe ata fiktivë të cilët pretendojnë se u rrezikohetjeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Sqarojmë se, shqetësimi i krijuar nga fenomeni i gjakmarrjes është trajtuar edhe në Progres Raportin e KE për Shqipërinë të vitit 2014.
- Gjakmarrja nuk është vlerësuar seriozisht nga strukturat shtetërore, të cilat fatkeqësisht nuk kanë dëshiruar që ta pranojnë atë. Këtë qëndrim e tregon edhe fakti që nuk ka statistika të sakta nga policia për numrin e të vrarëve për gjakmarrje, të familjeve

dhe të personave të ngujuar, mandje ato nuk administrohen as nga INSTAT-i. Kjo ndodh edhe për faktin se fenomeni është dinamik.

- Fenomeni është mesjetar, kriminal dhe jo i pastër kanunor.
- Fëmijët e ngujuar janë të destinuar të bëhen kriminelë për shkak të rrethanave ku jetojnë, të ndjenjës së urrejtjes me të cilën rriten dhe mungesës së shkollimit dhe edukimit.
- Nuk ka asnjë investim nga organet e shtetit dhe të drejtësisë për të nxjerrë personat nga ngujimi.
- Disa masa të marra për shtesa e ndryshime në Kodin Penal, duke rritur dënimin për autorët e vrasjes për gjakmarrje (jo më pak se 30 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm neni 78/a i Kodit Penal) dhe parashikimin e dy figurave të reja krimi, si “*kanosja serioze për tu mbyllur në shtëpi*” (neni 83/a i Kodit Penal) dhe “*nxitja për gjakmarrje*” (neni 83/b i Kodit Penal) për të cilat parashikohet dënnimi me burgim deri në tre vjet, nuk janë të mjaftueshme për të luftuar këtë fenomen.
- Ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” ndonëse ka mbi 8 vjet që ka hyrë në fuqi nuk ka gjetur zbatim. Kjo situatë duhet të marrë fund menjëherë dhe strukturat qendrore e vendore të parashikuara prej tij duhet të fillojnë punën e tyre intensive duke hartuar e miratuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ etj. Dhe të përcaktojnë detyrat dhe masat konkrete për organet administratës qendrore dhe ato të pushtetit vendor.
- Gjakmarrja nuk mund të zhduket për një vit apo për një mandat qeverisës por është e rëndësishme që të filloj puna intensive për ta luftuar atë.
- Gjakmarrja mund të luftohet me efektivitet vetëm në qoftë se strukturat shtetërore, shkollat, komunitetet fetare, media dhe shoqëria civile do të punojnë së bashku sipas një strategjie të përbashkët dhe planit të veprimit të miratuar nga qeveria.
- Policia e Shtetit duhet të mbajnë statistika të sakta për numrin e të vrarëve për gjakmarrje, dhe në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor dhe institucionet arsimore duhet të evidentojnë saktësisht numrin e familjeve dhe të personave të ngujuar duke përfshirë edhe të miturit që nuk shkojnë në shkollë. Për këtë problem u

sugjerua bërja e një rekomandimi drejtar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- Organet e Policisë së Shtetit duhetë marrin masa të menjihershme për parandalimin e konflikteve të ndryshme që janë një nga burimet e kimeve për hakmarrje e gjakmarrje, për zbulimin dhe kapjen sa më shpejt të autorëve të kimeve për gjakmarrje.

- Organet e prokurorisë duhet të bashkëpunojnë më mirë me policinë për të bërë hetime të shpejta, të plota, të thella dhe objektive. Nuk duhet mjaftuar vetëm me zbulimin e autorit të vrasjes, ekzekutorit, por duhen zbuluar edhe bashkëpunëtorët e tij, sikurse janë nxitësit e ndihmësit e autorit si dhe organizatorët e krimit.

- Gjykatat duhet t'i gjykojnë shpejt, me objektivitet, paanshmëri dhe mundësishët me gjykim të pandërprerë çështjet gjyqësore për këtë krim dhe të jepin dënimë të drejta për çdo fajtor. Çdo dënim i butë, apo pafajësi e pabazuar i lë shteg vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes.

- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet arsimimi dhe edukimi i mirë i brezit të ri me frymën e tolerancës, jo dhunës, pranimin e diversitetit, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Trajnimi i mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja është i rëndësishëm. Duhet të vazhdojë edhe për disa kohë Projekti “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit të përfitojnë të gjithë fëmijët e ngujuar dhe jo vetëm në qarkun e Shkodrës por edhe në qarqe të tjera të vendit ku është i përhapur ky fenomen. Për këtë problem u sugjerua bërja e një rekomandimi Ministres së Arsimit dhe Sportit.

- Familjet e ngujuar janë në gjendje të mjerueshme ekonomike.

- Problemet sociale të familjeve të ngujuara kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit, posaçërisht të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, që, nëpërmjet zyrave rajonale, të shkojnë tek familjet e ngujuara për ti dhënë mundësi të aplikojnë për ndihmë ekonomike atyre familjeve me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim uljen e nivelit të varfërisë. Për këtë çështje u sugjerua bërja e një rekomandimi Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

- Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj duhet t'u ofrojnë familjeve të ngujuara për shkak të gjakmarrjes shërbim shëndetësor në shtëpisipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron patientëve që janë regjistruar pranë saj. Për këtë çështje u sugjerua bërja e një rekomandimi Ministrit të Shëndetësisë.
- Të mbahen lidhje të vazhdueshme dhe të bashkëpunohet me OJQ që veprojnë dhe kontribuojnë për këtë problem kryesisht në qarkun e Shkodrës.

#### **4. Rekomandimet e bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit pas Konferencës Kombëtare.**

Në vijim të punës për konkretizimin e rekomandimeve të nxjerra nga konferanca dhe me qëllim sensibilizimin e strukturave shtetërore për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes, Avokati i Popullit ka vazhduar në mënyrë intensive punën e tij në këtë fushë për të mbrojtur të drejtat kushtetuese e ligjore të qytetarëve të cënuara nga ky fenomen. Pas konferencës janë përgatitur e dërguar institucioneve qëndrore të administratës publike rekomandimet e mëposhtme:

1. Rekomandimi i bërë në datën 23.12.2013 drejtar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet arsimimi dhe edukimi i mirë i brezit të ri me frymën e tolerancës, jo dhunës, pranimin e diversitetit, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Trajnimin e mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja. Vazhdimin edhe për disa kohë të Projektit “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit të përfitojnë të gjithë fëmijët e ngujuar në të gjitha qarqet e vendit.
2. Rekomandimi i bërë në datën 23.01.2014 drejtar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të bashkëpunojë me organet e pushtetit vendor dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale për regjistrimin e të gjitha vrasjeve për motiv gjakmarrjeje, të familjeve dhe të personave të ngujuar sipas gjinisë dhe grup moshave (meshkuj, femra, të mitur).

3. Rekomandimi i bërë në datën 12.02.2014 drejtar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që, nëpërmjet zyrave rajonale, të shkojnë tek familjet e ngujuara për ti dhënë mundësi të aplikojnë për ndihmë ekonomike atyre familjeve me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim uljen e nivelit të varfërisë.

4. Rekomandimi i bërë në datën 06.02.2014 drejtar Ministrisë së Shëndetësisë që tu ofrojë personave të ngujuar nga gjakmarrja shërbim shëndetësor në shtëpisipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj.

5. Rekomandimi i bërë në datën 07.02.2014 drejtar Ministrit të Punëve të Brendshme për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës dhe përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005. Pas kërkesave të përsëritura, Ministri i Punëve të Brendshme me shkresën nr. 3530/2 Prot., datë 22.09.2014 na ktheu përgjigje dhe na informoi se, ka filluar puna për ngritjen e Sekretariatit Teknik në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.

6. Në muajt e parë të vitit 2014 ka patur një reagim pozitiv të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me problemin e gjakmarrjes. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka nxjerrë një urdhër për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngujuara. Ky urdhër detyron organet vendore të Policisë së Shtetit, që të evidentojnë të gjitha familjet dhe personat që ndodhen të ngujuar për shkak të gjakmarrjes. Gjithashtu urdhërohen oficerët e policisë gjyqësore që të marrin kallëzime nga personat të cilët janë kanosur për t'u ngujuar.

Ne e vlerësuam shumë këtë veprim ligjor dhe kemi bindjen se ai do të ndikojë dhe influencojë në parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në rrethin e Shkodrës dhe për daljen e të ngujuarve. Ndërkohë gjykuam se, ky veprim pozitiv duhet të shtrihej edhe në organet e tjera të prokurorisë dhe konkretisht në ato rrethe të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes.

Për këtë qëllim në datën 03.03.2014 u bë Rekomandimidrejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për marrjen e masave të nevojshme që, nisma pozitive e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër "Për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngujuara", të shtrihet edhe në organet e tjera të Prokurorive të Rethive Gjyqësore

në ato rrethe të vendit të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes.

Sqarojmë se për të gjitha rekomandimet e cituara më lart jemi informuar se ato janë mirëpritur dhe pranuar.

Përveç sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit me mbështetjen e Projektit "Mbështetja e Danimarkës për Avokatin e Popullit Shqiptar - Më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)", sipas Planit Vjetor të aktiviteteve të Komponentit nr. 1 "Pushteti Lokal" në bashkëpunim me shoqatën "Partnerë për Fëmijët", ka realizuar Aktivitetin nr. 5: "*Prodhimi i materialeve informuese dhe promovuese*".

Për vitin 2014 janë përgatitur e prodhuar 100 postera lidhur me "Gjakmarrjen". Gjithashtu janë përgatitur e prodhuar edhe 100 postera "Për azilkërkuesit", problem i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me gjakmarrjen sepse azilkërkuesit e përdorin si motiv gjakmarrjen për kërkimin e azilit. Këto postera janë shpërndarë në zyrat rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe në ambjente të tjera ku është vlerësuar e arsyeshme nga institucioni ynë.

7. Meqënëse kaluan disa muaj nga dërgimi i përgjigjes së cituar më sipër nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe ende nuk kishim asnjë informacion për ecurinë e këtij problemi, me shkresat nr. K2/I37-23 Prot., datë 24.03.2015 dhe K2/137-27 Prot., datë 19.05.2015, i kërkuam Ministrit të Punëve të Brendshme të dërgonte informacion lidhur me ngritjen e Sekretariatit Teknikdhe ecurinë e procesit të hartimit të akteve nënligjore të parashikuara në ligjin nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes" dhe në Urdhrin e Kryeministrit nr.136, datë 14.11.2012.

Ministri i Punëve të Brendshme me shkresën nr. 4008/1 Prot., datë 09.06.2015, ndërmjet të tjerave na informoi se citojmë:

"Ministria e Punëve të Brendshme e ka të vështirë të realizojë e vetme një proces në të cilin përfshihen disa institucione.

Mosfunkcionimi i Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes është një problematikë e cila lidhet direkt me mosbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes".

Për sa më sipër mendojmë se duhet të propozohen amendimet e nevojshme ligjore të këtij ligji për zgjidhjen e kësaj situate”.

Ne kemi bindjen e plotë se miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” dhe qëllimi i këtij ligji janë për t'u vlerësuar si një hap pozitiv për ta luftuar këtë fenomen.

Ndërkohë theksojmë se, mosbatimi i këtij ligji, mosnxjerrja e miratimi i 3 akteve nënligjore në bazë e për zbatimin e tij dhe mosfunkcionimi i Këshillit Koordinues për këtë çështje për vite me radhë tregon se fenomeni nuk është adresuar si duhet nga institucionet shtetërore, lidhur me parandalimin dhe zhdukjen e tij. Këto shqetësime janë pasqyruar edhe në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri, miratuar në datën 05.03.2015.

Përgjigjia e fundit e Ministrit të Punëve të Brendshme, të cilën e cituam më lart, nuk flet për angazhim serioz të këtij institucioni për të zbatuar Urdhrin e Kryeministrit nr. 136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme.

Ne mendojmë se, nëse nga institucionet e përfshira në këtë ligj gjykohet dhe vlerësohet se për zgjidhjen e kësaj situate duhet të propozohen amendimet e nevojshme ligjore të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005, përsë nuk bëhen ato dhe kush i pengon. Ndërkohë vlerësojmë se kthimi i një përgjigjeje të tillë pas rreth dy vitesh dhe qëndrimi i mbajtur nga institucionet shtetërore duke mos e vënë në zbatim këtë ligj tregon se zgjidhja e problemit po sorollatet duke bërë e shkëmbyer shkresa ndërmjet institacioneve.

Për sa më sipër dhe me qëllim vënien në zbatim sa më shpejt të këtij ligji shumë të rëndësishëm për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes, me shkresën e datës 22.06.2015 i rekomanduam Kryeministrin:

“Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Marrjen e masave të nevojshme në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” për

përgatitjen dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji”.

## **5. Organizimi i disa aktiviteteve sensibilizuese për gjakmarrjen në Qarkun e Shkodrës gjatë vitit 2015.**

Gjatë vitit 2015 nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me disa OJQ, studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe organet e pushtetit vendor të qarkut Shkodër janë organizuar disa aktivitete, sikurse mund të përmendim:

Auditorumi për fenomenin e gjakmarrjesorganizuar në bashkëpunim me OSBE-në, mbajtur në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër në datën 27.03.2015. Qëllimi i këtij auditoriumi ishte diskutimi rreth fenomenit të gjakmarrjes, nxjerra e problemeve dhe sensibilizimi i organeve të pushtetit vendor për rritjen e efektivitetit të punës së tyre dhe të medias për të luftuar dhe parandaluar gjakmarrjen dhe hakmarrjen, si dhe pasojat e tyre. Në këtë aktivitet morën pjesëdhe diskutuan përfaqësues të Prefekturës së Qarkut Shkodër, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të Gjykatës së Apelit Shkodër, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, të Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, të Drejtorisë së Shërbimit Social Shkodër, të Drejtorisë së Shërbimit Shëndetësor Shkodër, të Komunitetit Musliman, të Komunitetit Katolik, të Komunitetit Ortodoks, të Komunitetin Bektashian të Shkodrës, të Shoqatës Operacione Colomba, të Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, studentë dhe përfaqësues të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, misionarë dhe kontribues të ndryshëm për parandalimin e këtij fenomeni, etj.

Një nga detyrat e përcaktuara në këtë auditorium ishte edhe organizimi i takimeve periodike të Institucionit të Avokatit të Popullit me organet vendore, komunitetet fetare dhe aktorët e tjera të shoqërisë civile që operojnë në këtë qark për të përcaktuar hapat e mëtejshëm të punës për parandalimin e këtij fenomeni.

Në takimin e radhës me pjesëmarrësit, nga Institucioni i Avokatit të Popullit u përgatit edhe një projekt Memorandum Bashkëpunimi “Për ngritjen dhe funksionimin e komitetit

*ndërinstitucional vendor për të koordinuar përpjekjet në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes*”, i cili u prezantua në datën 15.04.2015.

Ky memorandum kishte për qëllim ngritjen dhe funksionimin e komitetit ndërinstitucional vendor për të koordinuar përpjekjet në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes, për institucionalizimin e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me palët e përbashkruara më lart, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre publike apo civile në Qarkun Shkodër, në kuadrin e punës së përbashkët dhe garantimit të realizimit të misioneve të përbashkëta për të parandaluar fenomenin e gjakmarrjes dhe të pasojave të tij në këtë njësi administrative, zhvillimit të politikave dhe të strategjive, si dhe zbatimit të ligjeve në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese të shtetasve të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes.

Gjithashtu nëpërmjet tij synuam që:

- Të realizojmë një veprimtari të përbashkët dhe për të koordinuar përpjekjet në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes dhe pasojave të tij në Qarkun e Shkodrës;
- Të mbrojmë dhe garantojmë të drejtën themelore kushtetuese më të rëndësishme të njeriut, atë të jetës;
- Të respektojmë, mbrojmë dhe garantojmë të drejtat kushtetuese themelore të personave të ngujuar, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj, etj;
- Të rrisim bashkëpunimin në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit penal lidhur me zbulimin, kapjen dhe dënimin e autorëve të veprave penale të “vrasjes për gjakmarrje”, parashikuar nga neni 78/a i Kodit Penal, të “kanosjes serioze për tu mbyllur në shtëpi”, parashikuar nga neni 83/a i Kodit Penal dhe të “nxitjes për gjakmarrje”, parashikuar nga neni 83/b i Kodit Penal.

Memorandumi do të zbatohej midis palëve të lartpërmendura, për të përmbushur objektin e tij dhe do të konsistonte në:

- a) evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha vrasjeve me motiv gjakmarrjeje dhe hakmarrjeje të ndodhura pas vitit 1990;

- b) intensifikimin e përpjekjeve për kapjen dhe dënimin e autorëve të vrasjeve për gjakmarrje dhe hakmarrje që janë larguar në drejtim të paditur, si dhe gjetjen dhe kapjen e autorëve të dënuar me burgim në mungesë;
- c) identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve dhe personave të ngujuar për shkak të "kanosjes serioze për t'u mbyllur në shtëpi", parashikuar nga neni 83/a i Kodit Penal, si dhe ndjekjen penale dhe dënimin e autorëve të tyre;
- ç) identifikimin, ndjekjen penale dhe dënimin e autorëve të veprës penale të "nxitjes për gjakmarrje", parashikuar nga neni 83/b i Kodit Penal;
- d) evidentimin e familjeve dhe të personave të ngujuar për shkak të gjakmarrjes, sipas gjinisë dhe grup moshave (meshkuj, femra, të mitur);
- dh) evidentimin e fëmijëve të ngujuar dhe që kanë ndërprerë procesin mësimor për shkak të gjakmarrjes;
- e) evidentimin e familjeve të ngujuara me të ardhura ekonomike të pamjaftueshme të cilat kanë nevojë për ndihmë ekonomike;
- f) evidentimin e personave të ngujuar nga gjakmarrja të cilët kanë nevojë për shërbim shëndetësor në shtëpisipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj;
- g) evidentimin e nevojave për trajnimin e mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja;
- h) evidentimin e nevojave për të parë mundësinë e vazhdimit në Qarkun e Shkodrës të Projektit "Shansi i dytë" nëpërmjet të cilit të përfitojnë të gjithë fëmijët e ngujuar në të gjitha qarqet e vendit;
- i) ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për propozime në kuadër të përmirësimit dhe ndryshimit të legjisacionit në fuqi me fokus gjakmarrjen dhe hakmarrjen në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventat e ratifikuara nga shteti shqiptar në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut;
- j) marrjen e iniciativave të përbashkëta për të bërë rekomandime e propozime organeve publike për zbatimin e nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin

dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” dhe përgatitjen e miratimin e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të tij;

k) shkëmbimin e rregullt të informacionit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike, shkëmbimit të informacionit, vizitave të përbashkëta në terren, njoftimeve reciproke për raste të ndryshme që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje;

l) organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese periodike në nivel qarku, përfshirë edhe organizimin e fushatave të përbashkëta për ndërgjegjësimin e publikut.

Përfaqësuesit e palëve pjesëmarrëse në parim ranë dakort që të nënshkruhej ky memorandum. Ndërkohë pati edhe sugjerime për të bërë disa ndryshime e përmirësimë të vogla të tij dhe më pas të nënshkruhej në mbledhjen e radhës. Mirëpo drejtuesit vendor të Policisë së Shtetit dhe të Prokurorisë kérkuam dhënien e autorizimit nga eprorët përkatës. Ndonëse iu drejtuam atyre me kërkesë për dhënien e autorizimeve përkatëse për nënshkrimin e memorandumit, por ata e refuzuan kërkesën tonë dhe përrjedhojë ai nuk u nënshkrua.

## **6. Situata aktuale e fenomenit të gjakmarrjes në vend në bazë të të dhënave zyrtare**

Për të patur një informacion më të plotë dhe të saktë rreth problemit të gjakmarrjes në mënyrë të vazhdueshme u kemi kérkuar të dhëna statistikore organeve të Policisë së Shtetit.

Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit<sup>1</sup> rezulton se, për fenomenin e gjakmarrjes është hartuar një Plan Veprimi nr.1277 datë 24.10.2012, rrinovuar me Planin e Veprimit nr. 419, datë 31.03.2014, “Për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hakmarrjes”. Në kuadër të këtij plani në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është ngritur shtabi i drejtimit kundër kimeve me motive gjakmarrje dhe hakmarrje, i cili ka për detyrë

<sup>1</sup> Shkresat nr. 674/1 Prot., datë 17.02.2014 dhe nr. 3505 Prot., datë 11.06.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërguar Avokatit të Popullit

të drejtojë, kontrollojë dhe koordinojë të gjithë veprimtarinë e strukturave vartëse për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të krimit të vrasjes të kryer për gjakmarrje apo hakmarrje si dhe të informojë në mënyrë periodike apo sa herë që kërkohet Drejtorin e Përgjithshëm apo Ministrin e Punëve të Brendshme për situatën e gjakmarrjes.

Objekti i këtij Plani Veprimi është:

- Goditja e fenomenit të gjakmarrjes dhe hakmarrjes duke bashkëpunuar ngushtë me poshtetin vendor dhe organizatat jo fitimprorëse për zgjidhjen me pajtim të konflikteve;
- Forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë për hetimin e shpejtë të këtyre veprave penale dhe vënien para drejtësisë të autorëve të tyre;
- Organizimi i masave të gjithanshme për kapjen e autorëve të vrasjeve në tërësi dhe të atyre për gjakmarrje në veçanti si një masë e madhe parandaluese për vazhdimin e gjakmarrjes;
- Forcimi i bashkëpunimit me drejtoritë arsimore dhe shkollat për edukimin e brezit të ri me fryshtë e tolerancës dhe parandalimin e krimit.

Sipas të dhënave statistikore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërguar me shkresat e cituara më sipër rezulton se, gjatë vitit 2013 janë evidentuar 107 vrasje me dashje nga të cilat janë zbuluar 85 ose 79.4 % e tyre, nga këto raste 4 vrasje janë me motiv gjakmarrje, respektivisht në Lezhë, Elbasan, Fushë Krujë dhe Mat.

Ndërsa gjatë vitit 2014 janë evidentuar 3 vrasje me motive gjakmarrje të ndodhura në qarqet Shkodër (dy) dhe Dibër (një). Nga total i 3 vrasjeve me motiv gjakmarrje të ndodhura në vitin 2014 janë zbuluar 3 prej tyre.

Nga statistikat e ardhura nga Drejtoritë e Policisë së Qarqeve rezulton se aktualisht në vendin tonë ndodhen 60 familje të ngujuara (me vetkufizim lirie) me 145 persona, nga të cilët 40 janë të mitur.

**Numri i familjeve dhe i personave të ngujuar për shkak të gjakmarrjes sipas qarqeve e rretheve në vend është respektivisht;**

- **Qarku Shkodër:** janë 57 familje të ngujuara me 132 persona, nga të cilët 36 fëmijë që nuk shkojnë në shkollë;

- **Rrethi Shkodër:** janë 46 familje të ngujuara me 117 persona, nga të cilët 28 fëmijë që nuk shkojnë në shkollë;
- **Rrethi Malësi e Madhe:** janë 11 familje me 15 persona, nga të cilët 8 fëmijë që nuk shkojnë në shkollë;
- **Rrethi Pukë:** nuk ka familje e persona të ngujuar;
  
- **Qarku Lezhë:** janë 2 familje të ngujuara me 8 persona, nga të cilët 4 fëmijë që nuk shkojnë në shkollë;
- **Rrethi Lezhë:** janë 2 familje të ngujuara me 7 persona, nga të cilët 3 fëmijëqë nuk shkojnë në shkollë;
- **Rrethi Kurbin:** 1fëmijë që nuk shkon në shkollë;
- **Rrethi Mirditë:** nuk ka familje e persona të ngujuar;
  
- **Qarku Kukës:** është 1 familje e ngujuar me 4 persona;
- **Rrethi Has:** është 1 familje e ngujuar me 4 persona;
- **Rrethi Tropojë:** nuk ka familje e persona të ngujuar;
  
- **Qarku Durrës:** është 1 person i ngujuar;
- **Rrethi Krujë:** është 1 person i ngujuar;
  
- **Në qarqet Tiranë, Dibër, Elbasan, Korçë, Fier, Vlorë, Berat dhe Gjirokastër** nuk familje dhe persona të ngujuar.

Nga informacioni dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit konstatojmë se, numri i familjeve dhe i personave të ngujuar krasuar me të dhënat e dërguara përvitet e mëparshme është në rënien.

Sipas statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme<sup>2</sup> rezulton se, për periudhën kohore 2010 deri 9 mujorin e vitit 2014 për krimin e vrasjes për gjakmarrje apo hakmarrje janë evidentuar respektivisht:

---

<sup>2</sup>Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme dërguar Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, me shkresën nr. 3730/1 prot., dt. 17.11.2014

- në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime me 5 të pandehur;
- në vitin 2011 janë regjistruar 6 procedime me 3 të pandehur;
- në vitin 2012 janë regjistruar 6 procedime me 8 të pandehur;
- në vitin 2013 janë regjistruar 10 procedime me 6 të pandehur;
- në 9 majoren e vitit 2014 janë regjistruar 9 procedime me 9 të pandehur.

Sqarojmë se nga këto të dhëna rezulton se, krimi i vrasjeve për gjakmarrje apo hakmarrje ka një rritje, fakt që e justifikon shqetësimin e ngritur nga Institucioni i Avokatëve i Popullit që prej disa vitesh.

Përhapja dhe shtrirja gjeografike e këtyre veprave në përqindje është:

- 46 % në Shkodër;
- 16 % në Korçë;
- 13 % në Tiranë;
- 9 % në Lezhë;
- me nga 6 % në Kurbin dhe Elbasan;
- me nga 3 % në Mat, Dibër, Kukës e Durrës.

Referuar të dhënave statistikore për periudhën 2010 deri 9 majoren 2014, prokurorët për të akuzuarit për këto dy krimet kanë kërkuar deklarimin fajtor dhe dënimin e:

- 6 personave me burgim të përjetshëm;
- 11 personave më maksimumin e burgimit që parashikon nenin përkatës i Kodit Penal;
- 4 persona me mesataren e burgimit dhe vetëm 1 me minimumin e burgimit të parashikuar nga ligji dhe lidhet me rastin e një autori të mitur.

Ndërsa gjykatat kanë vendosur/dhënë:

- 9 dënime me maksimumin e burgimit që parashikon ligji;
- asnjë dënim me burgim të përjetshëm;
- 11 dënime mesatare të burgimit që parashikon ligji;
- 2 dënime në masën minimale të burgimit që parashikon ligji.

#### **Vrasjet për gjakmarrjerezultojnë si vijon:**

- në vitin 2010 nuk është regjistruar asnjë procedim penal;
- në vitin 2011 janë regjistruar 2 procedime penale, me 2 të pandehur;
- në vitin 2012 janë regjistruar 4 procedime penale, me 3 të pandehur;
- në vitin 2013 janë regjistruar 3 procedime penale, me 2 të pandehur;

- në 9 mujorin 2014 janë regjistruar 5 procedime penale, me 5 të pandehur.

**Të dhënrat për të pandehurite regjistruar gjatë kësaj përiudhe në total janë:**

**Sipas gjinisë:**

- 93 % meshkuj;
- 7 % femra.

**Sipas moshës:**

- të pandehurit janë të gjithë madhorë.

**Sipas arsimit:**

- 80 % janë me arsim 8 vjeçar;
- 20 % me arsim të mesëm.

**Sipas vendbanimit:**

- 20 % e të pandehurve janë me banim në qytet;
- 80 % e tyre janë me banim në komuna.

**Sipas punësimit:**

- 87 % e të pandehurve kanë qënë të papunë;
- 13 % e tyre të punësuar.

**Lidhur me pasojet e krimit të vrasjes për gjakmarrje rezulton se:**

- në pesë vitet e fundit kanë gjetur vdekjen 9 persona;
- janë plagosur rëndë 2 persona;
- është plagosur lehtë 1 person.

**Vrasjet për hakmarrje rezultojnë si vijon:**

- në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime penale, me 5 të pandehur;
- në vitin 2011 janë regjistruar 4 procedime penale, me 1 të pandehur;
- në vitin 2012 janë regjistruar 2 procedime penale, me 5 të pandehur;
- në vitin 2013 janë regjistruar 7 procedime penale, me 4 të pandehur;
- në 9 mujorin 2014 janë regjistruar 4 procedime penale, me 4 të pandehur.

**Të dhënrat për të pandehurite regjistruar gjatë kësaj përiudhe në total janë:**

- 100 % meshkuj;
- 94 % janë madhorë;
- 6 % janë nën moshën 18 vjeç.

**Përsa i përket arsimit të tyre:**

- 70 % janë me arsim 8 vjeçar;
- 26 % janë me arsim të mesëm;
- 4 % me arsim të lartë.

**Vendbanimi:**

- 59 % e të pandehurve janë me banim në qytet;
- 41 % e tyre janë me banim në komuna.

**Punësimi i të pandehurve:**

- 41 % e tyre kanë qënë të papunë;
- 59 % e tyre të punësuar.

**Lidhur me pasojat e krimittë vrasjes për hakmarrje rezulton se:**

- në pesë vitet e fundit kanë gjetur vdekjen 11 persona;
- ka mbetur i plagosur lehtë 1 person.

**Kanosja për hakmarrje ose gjakmarrje:**

Numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kanosjes serioze për hakmarrje rezulton të jetë:

- në vitin 2012 janë regjistruar 2 procedime penale;
- në vitin 2013 janë regjistruar 3 procedime penale.

Ndërsa për veprën penale të kanosjes serioze për gjakmarrje rezulton të jetë:

- në vitin 2012 janë regjistruar 2 procedime penale;
- në vitin 2013 janë regjistruar 7 procedime penale;
- në 9 muajin e 2014 janë regjistruar 7 procedime penale.

**Nxitja për gjakmarrje:**

Për veprën penale të nxitjes për gjakmarrje janë evidentuar:

- në periudhën 2010-2013 nuk është regjistruar asnjë procedim penal;
- në 9 muajin 2014 është regjistruar 1 procedim penal.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme nuk ka statistika të sakta lidhur me familjet dhe personat e ngujuar për shkak të gjakmarrjes. Pozitiv është fakti i iniciativës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe hartimi i një plani konkret për të identifikuar dhe regjistruar familjet që janë në gjakmarrje dhe që janë ngujuar për këtë shkak.

Në zbatim të këtij plani, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit dhe drejtuesit vendorë të 15 bashkive dhe komunave në rrethet Shkodër dhe Malësi e Madhe, kanë regjistruar familjet që janë në gjakmarrje, kanë kontaktuar me familjet e ngujuara, si dhe kanë marrë deklarime nga personat e ngujuar nëse janë kanosur për gjakmarrje ose hakmarrje, për të vijuar më tej hetimet ndaj personave përgjegjës në formën procedurale të kërkuar nga ligji.

Sipas prokurorisë, nga të dhënat e administruara në këtë zonë rezulton se, shifra e familjeve dhe e personave të ngujuar është shumë herë më e vogël se shifrat që raportohen nga shoqata të ndryshme. Në këto dy rrethe janë kontaktuar 200 familje të cilat janë në konflikt për vrasje që nga viti 1990, prej të cilëve 25 familje janë të ngujuara me 25 persona. Nga kontaktet e drejtpërdrejta me personat e ngujuar, rezulton se vëtëm 4 kanë paraqitur kallëzim penal për kanosje për gjakmarrje, ndërsa personat e tjerë janë shprehur se nuk janë kanosur drejtpërdrejtë, por qëndrojnë të ngujuar për shkak të frikës.

Kjo iniciativë dhe përvojë pozitive e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, po formalizohet për të normuar kryerjen e kësaj veprimtarie, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe organet e pushtetit vendor edhe në prokuroritë e rretheve të tjera gjyqësore, në të cilat ka familje të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes dhe hakmarrjes, si dhe familje të ngujuara, me synimin për të kriuar një databazë homogjene dhe të besueshme për numrin e familjeve të prekura nga gjakmarrja dhe të personave të ngujuar.

## **7. Azilkërkuesit shqiptarë në shtetet e zonës Shengen, mashtrimet me gjakmarrjen për të kërkuar azil në shtetet anëtare të BE-së dhe reagimi i strukturave ligjzbatusë shqiptare:**

Liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë për të udhëtuar në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, u bë me vendimin unanim të Ministrave të Brendshëm të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian më 16 dhjetor 2010. Pas këtij vendimi historik për vendin tonë, qytetarët shqiptarë mund të

udhëtojnë pa viza edhe në vende të tjera të zonës Schengen, që nuk janë anëtarë të BE, të tilla si: Islanda, Lihenshtajni, Norvegjia e Zvicra. Në bazë të këtij vendimi qytetarët e Shqipërisë do të gjëzojnë të drejtën për lëvizje të lirë në zonën Schengen si dhe të drejtën e qëndrimit deri në tre muaj, për qëllime turistike, por pa patur mundësinë që të jetojnë dhe punojnë në këto vende.

Mirëpo vendimi në fjalë u shoqërua me një deklaratë, me anë të së cilës përmendet mundësia për rivendosjen e vizave, në rast se ndonjë vend anëtar e sheh këtë të arsyeshme, gjithnjë nëse konstatohen abuzime.

Pas heqjes së regjimit të vizave konstatohet se, lëvizja e lirë e shtetasve shqiptarë në hapësirën Schengen, ka shkaktuar edhe raste të shumta të kërkesave për të qëndruar në këto vende si dhe rritjen e kërkesave për azil, që në mjaft raste janë të paargumentuara dhe për rrjetojë janë refuzuar nga organet përkatëse. Duhet theksuar që Kodi Kufitar i Hapësirës Schengen<sup>3</sup> vendos një sërë kushtesh për lirinë e lëvizjes të personave që udhëtojnë nga vendet e treta drejt hapësirës Schengen, përfshirë dhe Shqipërinë, të cilat janë:

- a) *Zotërimi i një dokumenti të vlefshëm udhëtimi ose dokumente që autorizojnë ata të kalojnë kufirin;*
- b) *Posedimi të një vize të vlefshme, në qoftë se kërkohet në pajtim me Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 539/2001 e 15 mars 2001, duke renditur vendet e treta shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga kjo kërkesë, përveç rasteve kur ata mbajnë një leje qëndrimi të vlefshme;*
- c) *Justifikimi i qëllimit dhe kushteve të qëndrimit, dhe posedimi i mjeteve të mjaftueshme të jetesës, si për kohëzgjatjen e qëndrimit, ashtu dhe për kthimin në vendin e tyre të origjinës ose për tranzitin në një vend të tretë, në të cilin ata janë të sigurt do të pranohen, ose nëse janë në gjendje për të blerë mjetet e tilla në mënyrë të ligjshme;*
- d) *Ata nuk janë persona për të cilët është lëshuar një alarm SIS për qëllime të refuzimit të hyrjes;*

---

<sup>3</sup>Rregullorja 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE, datë 15.03.2006 “Mbi rregullat që përcaktojnë lëvizjen e personave në kufijtë Shengen”.

e) *Ata nuk konsiderohen të jenë një kërcënëm për politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjë prej shteteve anëtare, sidomos kur në bazën e të dhënave kombëtare të shteteve anëtare nuk rezulton asnjë alarm, që të jetë është lëshuar për qëllimin e refuzimit të hyrjes në të njëjtat baza.*<sup>4</sup>

Në lidhje me azilin, Kodi Kufitar i Hapësirës Sshengen përcakton se: “*Shtetasi i vendeve të treta që nuk i përmbrush të gjitha kushtet e hyrjen në hapësirën Schengen të përcaktuara në Nenin 5 (1) (si më lart) dhe që nuk i përket kategorive të personave të përmendur në Nenin 5 (4), do t'i refuzohet hyrja në territoret e shteteve anëtare. Kjo nuk cënon zbatimin e dispozitave të veçanta në lidhje me të drejtën e azilit dhe të mbrojtjes ndërkombëtare apo dhënien e vizave me qëndrim të gjatë.*<sup>5</sup>

Më 12 shtator 2013, Parlamenti Evropian mbështeti iniciativën e anëtarëve të BE, për miratimin e një klauzole mbrojtëse, e cila i mundëson shtetet anëtare të hapësirës Schengen për të riaktivizuar regjimin e vizave për vendet e treta të cilat paraqesin një rrezik potencial për emigracion. Amendimi i rregullores (EC) nr. 539/2001, “*Vendet e treta shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe shtetasit tek të cilët nuk aplikohet ky detyrim*” përcakton se, që nga data 9 janar 2014, në qoftë se një vend anëtar i BE përballet me një rritje të papritur emigrantësh të parregullt ose azilkërkuesish, ai do të duhet të njoftojë Komisionin Evropian. Komisioni më tej duhet të propozojë pezullimin e udhëtimit pa viza për vendin ose vendet e origjinës për një periudhë fillestare prej gjashtë muajsh. Nëse situata nuk përmirësohet brenda kësaj kohe, udhëtimi i lirë me këto vende mund të pezullohet për një kohë të papërcaktuar.

Sipas të dhënave nga organet e specializuara të BE, rezulton se numri i kërkesave për azil nga Shqipëria ka qënë i konsiderueshëm dhe nga viti në vit rritje.<sup>6</sup>

Për vitin 2013 raportohet se, numri i kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë ka qenë 10,599.<sup>7</sup> Nga informacionet që kemi marrë gjatë kontakteve me përfaqësues të institucioneve të BE-së dhe të përfaqësive diplomatike anëtare të këtij unioni të

<sup>4</sup> Neni 5 i Rregullores 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE, datë 15.03.2006 “Mbi rregullat që përcaktojnë lëvizjen e personave në kufijtë e hapësirës Schengen”.

<sup>5</sup> Neni 13 i Rregullores 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE.

<sup>6</sup> Këto të dhëna i referohen Raportit Vjetor të EASO për vitin 2012.

<sup>7</sup> UNHCR, “Asylum Levels and Trends in Industrialised Countries”, 2013, faqe 27.

akredituara në Shqipëri rezulton, që, edhe gjatë vitit 2014 dhe 2015 numri i azilkërkuesve shqiptarë në këto vende është i konsiderueshëm dhe i lartë.

Nga analiza e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë, rezulton se një ndër motivet kryesor që paraqesin shtetasit shqiptarë në kërkesën e tyre në momentin e aplikimit për azil është gjakmarrja.

Sikurse rezulton, gjakmarrja në Shqipëri tashmë është kthyer në një fenomen shumë shqetësues jo vetëm për shoqërinë tonë por edhe edhe për disa vende të BE-së për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptarë të cilët pretendojnë se u rrezikohetjeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Raporte të ndryshme në lidhje me azilkërkuesit, nxjerrin që një ndër faktorët kryesorë në kërkesën për azil të shtetasve shqiptarë në BE ka të bëjë me gjakmarrjen.<sup>8</sup>

Kjo situatë ka sjellë si pasojë presionin e disa vendeve anëtare të BE-së drejtuar KE-së për pezullimin e udhëtimit pa viza të shtetasve shqiptarë në zonën Schengen. Ndërkohë nga të dhënat e siguruara nga autoritetet e vendeve të huaja në bashkëpunim me strukturat ligjzbatuese shqiptare rezulton se shumë nga azilkërkuesit shqiptarë kanë mashtruar me motivin e gjakmarrjes duke siguruar e paraqitur dokumenta të fallsifikuara sikur janë pjestarë të familjeve që janë në gjakmarrje dhe se u rrezikohetjeta në Shqipëri.

Kjo situatë kërkon një ndërhyrje të menjëhershme të qeverisë shqiptare për të mos rrezikuar penalizimin dhe pezullimin e lëvizjes pa viza të shtetasve shqiptarë në zonën Schengen.

Vlen të theksohet fakti se Policia Kufitare dhe Migracionit (PKM), me qëllim marrjen e masave për të ndaluar çdo tentativë për kalim të kufirit të shtetasve që nuk u lejohet hyrja në BE, përfshirë dhe ata që kanë kërkuar azil, ka evidentuar në bazën e saj të të dhënave Sistemim TIMS të gjithë shtetasit, të cilët kanë shkelur rregullat e qëndrimit në një nga vendet e zonës Schengen dhe që iu është ndaluar hyrja në këtë zonë për një periudhë të caktuar kohe.

---

<sup>8</sup>Asylum applicants from the Eastern Balkans comparative analysis of trends, push-pull factors and responses, EASO, 2013, faqe 43.

Në këto kushte, e gjithë problematika ka të bëjë me mirëqeverisjen dhe mirëfunksionimin e shtetit ligjor dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të shtetasve në vend, të sanksionuara në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi.

Ndërsa Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të angazhimeve institucionale, në bashkëpunim me autoritetet e huaja bazuar në të dhënrat për familjet e prekura nga fenomeni i gjakmarrjes ka krijuar një panoramë mbi përhapjen e këtij fenomeni për të shhangur mashtimet me anë të përdorimit të dokumentave të fallsifikuara, me të cilët është pretenduar si shkak gjakmarrja për të kërkuar azil në shtetet anëtare të BE-së.

Organet ligjzbatuese të policisë dhe prokurorisë kanë vlerësuar shqetësimin e homologëve europianë lidhur me numrin në rritje të azilkërkuesve shqiptarë, të cilët paraqesin si shkak gjakmarrjen. Iniciativa e Prokurorisë, e cila nisi nga Shkodra është në vijim të bashkëpunimit me autoritetet e huaja për të evidentuar personat që abuzojnë me lirinë e lëvizjes, duke kërkuar azil me dokumenta të fallsifikuara si të përfshirë në gjakmarrje.

Gjatë kësaj periudhe kohore, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Durrës e Shkodër, në bazë të referimeve të Departamentit të Krimit të Organizuar dhe të Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë ushtruar ndjekje penale dhe kanë ngritur akuzë në gjykatë ndaj 16 të pandehurve, përkatësisht: ndaj Kryetarit të Asamblesë Kombëtare të Misionarëve të Pajtimit të Gjaqeve në Durrës dhe dy bashkëpunëtorëve të tij; ndaj Kryetarit të Komunës Postribë dhe tre kryepleqve të fshatrave Mes, Boks e Drisht të kësaj komune; ndaj Sekretarit të Shoqatës së Misionarëve të Paqes, kryeplakut të fshatit Shtoj, Komuna Rrethina dhe 7 shtetasve, të akuzuar për veprat penale “Korrupsion pasiv në sektorin privat”, “Fallsifikim të dokumentave nga personi që e ka për detyrë lëshimin e dokumentit” dhe “Përdorim të dokumentave të fallsifikuara”, parashikuar nga nenet 164/b, 186/3 dhe 186/2 të Kodit Penal, përfaktin se kanë lëshuar dokumenta të fallsifikuara sikur personat kanë qënë të përfshirë në gjakmarrje, me qëllim përdorimin e gjakmarrjes si argument për të kërkuar azil në Belgjikë.

Kjo përvojë pozitive e bashkëpunimit me autoritetet belge po shtrihet edhe me autoritetet e shteteve të tjera anëtare të BE-së, për të verifikuar dhe vënë para përgjegjësisë penale të gjithë personat që me anë të përdorimit të dokumentave të

fallsifikuara, pretendojnë si shkak gjakmarjen për të kërkuar azil në ato shtete anëtare, me synimin që t'i jepet fund mashtrimit me përdorimin e gjakmarrjes si argument bazë për të kërkuar azil në shtetet anëtare, siç rekomandon edhe Progres Raporti i BE-së i vitit 2014 për vendin tonë.<sup>9</sup>

## **8. Konkluzione dhe Rekomandime për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes**

Megjithëse kohët e fundit po flitet dhe pranohet ekzistencë e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri, por strukturat shtetërore nuk janë angazhuar në mënyrë totale dhe serioze për ta luftuar atë.

Ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” ndonëse ka mbi 10 vjet që ka hyrë në fuqi, por fatkeqësisht ai nuk ka gjetur zbatim.

Zbatimi i këtij ligji nga strukturat qendrore e vendore të parashikuara prej tij përbën domosdoshmëri për të luftuar me sukses këtë fenomen.

Presidenti i Republikës nuk ka zbatuar detyrimin ligjorpër thirrjen dhe mbledhjen e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes. Ne gjykojmë se thirrja e këtij këshilli nga Presidenti, në cilësinë e drejtuesit të tij, jo vetëm nuk pengohet nga mosmiratimi i tre akteve nënligjore, por do të ishte një mesazh pozitiv për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes dhe ndërkokë do të shërbente si nxitje për organet e administratës për miratimin e tyre.

Urdhri i Kryeministrat nr.136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, cili kryesohet nga Zëvëndësministri i Punëve të Brendshme nuk është zbatuar akoma dhe tre aktet nënligjore jo vetëm që nuk janë miratuar por ato nuk janë përgatitur ende nga grupi i punës.

---

<sup>9</sup>Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme dërguar Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, me shkresën nr. 3730/1 prot., dt. 17.11.2014

Hartimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe respektivisht edhe i planit të veprimit për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ, etj. dhe përcaktimi i detyrave dhe i masave konkrete për institucionet shtetërore, shoqërore, shkencore, fetare, etj. është imediat.

Disa masa të marra për shtesa e ndryshime në K.Penal, duke rritur dënimin për autorët e vrasjes për gjakmarrje (jo më pak se 30 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm neni 78/a i KP) dhe përfshirja e dy figurave të reja krimi, si “kanosja serioze për t'u mbyllur në shtëpi”(neni 83/a i KP) dhe “nxitja për gjakmarrje” (neni 83/b i KP për të cilat parashikohet dënim me burgim deri në tre vjet) nuk janë të mjaftueshme për të luftuar këtë fenomen.

Gjakmarrja mund të luftohet me efektivitet vetëm në qoftë se strukturat shtetërore, shkollat, komunitetet fetare, media dhe shoqëria civile do të punojnë së bashku sipas një strategjie të përbashkët.

Evidentimi i saktë dhe i plotë i numrit të familjeve dhe të personave të ngujuar është me rëndësi për të kuptuar përmasat dhe shtrirjen e fenomenit të gjakmarrjes dhe të ngujimit i cili është një nga pasojat tragjike të tij. Organet e policisë, të prokurorisë, të pushtetit vendor dhe institucionet rajonale arsimore nuk kanë bashkëpunuar sa dhe si duhet për të evidentuar saktësisht numrin e familjeve dhe të personave të ngujuar.

Duhet të zbatohet në mënyrë imediate ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Duget të miratohen menjëherë nga KM tre aktet nënligjore në bazë e për zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë penale duhet të rrisin eficencën, angazhimin dhe kontributin e tyre për të garantuar minimizimin me tendencë zhdukjen e fenomenit të gjakmarrjes.

Organet e policisë, të prokurorisë, të pushtetit vendor dhe institucionet rajonale arsimore të rrisin bashkëpunimin ndërmjet tyre për të njojur realisht gjendjen e përgjithshme në bazë rrethi gjyqësor, bashkie, komune dhe fshati të familjeve të prekura dhe të ngjuara nga gjakmarrja dhe hakmarrja për të krijuar evidenca me të

dhëna të sakta dhe të besueshme lidhur me numrin e familjeve dhe të personave të ngujuar.

Rritja e kapaciteteve gjurmuese dhe hetuese të strukturave të specializuara të Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur zbulimin dhe arrestimin e të gjithë autorëve të vrasjeve të pazbuluara me çështje penale të pezulluara gjatë viteve, me synimin për të parandaluar vazhdimin e vrasjeve zinxhir për motivin e gjakmarrjes të personave të pafajshëm dhe për të rritur sigurinë e komunitetit ku ata banojnë.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë të paekzekutura nga strukturat e Policisë së Shtetit, të mbartura në vite, ndaj autorëve të dënuar për vrasje të cilët i fshihen drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit. Zbatimi i kësaj mase ndaj personave të kriminalizuar dhe të dënuar që duheshin izoluar nga shoqëria, lëvizin lirshëm dhe cënojnë gjendjen e sigurisë në komunitet. Ndërkohë marrja e kësaj mase do të ndikojë dukshëm në parandalimin e vazhdimit të vrasjeve zinxhir për gjakmarrje të personave të pafajshëm.

Në çdo rast të ndodhjes së vrasjeve për gjakmarrje dhe hakmarrje, nga organet e policisë, prokurorisë dhe gjykatës kërkohet ushtrimi me efektivitet i funksioneve të tyre për zbulimin dhe arrestimin e menjëhershëm të autorit të saj, për ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykimin në afate kohore sa më të shpejta dhë për dënimin e autorëve me llojin dhe masën e dënitit më të ashpër që parashikohet nga ligji.

Duhet të rritet bashkëpunimi me autoritetet homologe të vendeve të BE-së për të evidentuar, verifikuar, hetuar dhe vënë para përgjegjësisë ligjore penale personat që me anë të përdorimit të dokumentave të fallisikuara kanë pretenduar si shkak gjakmarrjen për të kërkuar azil në ato shtete, me synimin që t'i jepet fund mashtrimit me përdorimin e gjakmarrjes si argument i pabazë për të kërkuar azil në vendet anëtare.

Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet edukimi i brezit të ri me frymën e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes, si dhe për trajtimin e mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja, duke vazhduar edhe për disa kohë Projektin “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit përfitojnë fëmijët e ngujuar. Migjithatë synimi kryesor duhet të jetë nxjerra e fëmijëve nga ngujimi dhe bashkimi, edukimi dhe arsimimi i tyre me shokët në shkollë.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet zyrave rajonale, të ndihmojnë ekonomikisht familjet e ngujuara me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe për të ulur nivelin e varfërisë. Gjithashtu ky institucion në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor duhet t'u japë zgjidhje problemit të strehimit të familjeve të prekura nga gjakmarrje, të cilat për arsyen sigurie kanë migruar nga vendbanimi i tyre në rrethe të tjera apo që janë rikthyer nga vendet e BE-së për shkak të refuzimit të dhënies së azilit. Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj rajonale duhet të vazhdojnë ofrimin e shërbimit shëndetësor në shtëpi familjeve të ngujuara nga gjakmarrja, sipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj.